



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 16/14 Prot

Vlorë, më 24 .10 . 2022.

VENDIM

Nr. 14 , datë 14.10.2022

PËR

**AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME
BLEKTORALE KUR SHOQËROHET ME INSTALIME TUBACIONESH DHE
NDËRTIME OBJEKTESH, ME VENDNDODHJE: FSHATI DRASHOVICË, BASHKIA
SELENICË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blektorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektësh, me vendndodhje: Fshati Drashovicë, Njësia Administrative Kotë, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Kuaternar

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

X 464948.085 Y 4478333.508 Z 60 m.m.n.d

Koordinatat e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)
X 464948.085 Y 4478333.508 Z 60 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime blektorale, konkretisht në fushën e mbarështimit të shpendëve për prodhim mishi dhe vezësh.

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=1.5$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{mes-vjet}=1.5$ l/sek

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)
X 464924 Y 4478379 Z 60 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.115$ l/s

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Gropë septike

3.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ